


MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË

ERSELDA SEFA



RELACION

RINDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE "HYSEN XHEKA"
KARBUNARË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT


MIMOZA HAXHIU

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Mimoza Haxhiu", is written below the printed name.

VENDNDODHJA DHE AKSESUESHMERIA

Shkolla 9-vjecare "Hysen Xheka" e ndërtuar përgjatë viteve 1965-1966, ndodhet në fshatin e Karbunarës dhe shtrihet përgjatë "Rruges së Beratit". Kjo shkollë është e aksesueshme nga të trija anët e saj, fillimisht nga rruga kryesore "Rruga e Beratit" ku shkolla ka edhe hyrjen ekzistuese të saj, si dhe më pas nga dy degëzimet e kësaj rruge të cilat janë dy rrugica të ngushta, ku vetëm njëra prej tyre të lejon hyrjen për në parcelën e shkollës, pasi aty ndodhet porta e hyrjes ekzistuese.

Shkolla është një godinë 2 katëshe me muraturë mbajtëse tulle 45 cm, mbuluar me taracë, e ndërtuar afërsisht në vitin 1948.



PLANVENDOSJE EKZISTUESE SH -1:800

GJËNDJA AKTUALE

Në parcelë aktualisht gjendet i vendosur objekti i shkollës. Parcela rrethohet nga një mur rreth të 90 cm i lartë sipër të cilit janë të vendosura kangjella hekuri. Vetë shkolla është e vendosur në një terren kodrinor me pjerrësi të theksuar, e cila me kalimin e kohës prej shkaqeve natyrore është theksuar edhe më tepër. Duke qenë se në vendndodhje ka patur erosion, ujërat kanë dëmtuar objektin e shkollës si dhe vetë terrenin ku ajo ndodhet. Objekti është i ngritur vetëm në një kat në pjesët anësore të tij dhe në pjesën e mesit është i ngritur në dy kate lartësi. Forma aktuale e objektit është forma U. Objekti i shkollës ka dëmtime të theksuara si në pjesën e brendshme po ashtu edhe gjatë pjesës së fasadës. Konkretisht kemi të bejmë me pjesën e lagështisë në të shumtën e ambienteve të shkollës, klasat pa xhama dritaresh , muret me myk dhe rënië të suvasë, banjot janë jashtë dhe pa kushte higjieno sanitare. Të gjitha këto problematika kanë sjellë vendimin për tu rindërtuar nga fillimi duke e rikonceptuar në një objekt të ri, estetikisht i rregullt si dhe funksional.



FOTO TË GJËNDJES EKZISTUESE






FOTO TË GJËNDJES EKZISTUESE

PERSHKRIMI I PROJEKTIT




OBJEKTI I PROPOZUAR



PLANVENDOSJE E OBJEKTIT TE PROPOZUAR SH - 1:800



Forma ka në koncept vendosjen e dy kuboidëve njëri mbi tjetrin. Kjo zgjidhje arkitektonike krijon funksionalitet dhe ndarje të zonimit për pjesën e fillores dhe kopshtit që ndodhet në katin përde dhe pjesën e 9 – vjecares që ndodhet në katin e sipërm. Pjesa e sipërme paraqet një zgjatim të pjesës së poshtme, duke u ngritur mbi kolona dhe duke e lënë hapësirën e katit përde të shfrytëzueshme për sistemim.

PLANI I KATIT PËRDHE , KUOTA ±0.00





Në katin përdhe, kuota ±0.00 ndodhet hapësira e hyrjes, e cila bëhet edhe ndarëse e hapësirave të brendshme funksionale. Në anën e majtë të planit, në pjesën jugore me ndricim natyral të plotë, janë të vendosura klasat e mësimit të 9-vjecares si dhe grupi i tualeteve për to. Në pjesën veriore ndodhen labororet, zyrat e administrates, salla e arsimtarëve, si dhe grupi i tualeteve për administratën, dhe në anën e majtë te planit, gjenden hapësirat dedikuar para shkollorit, në një pjesë totalisht të shkeputur nga pjesa e 9 – vjecares.

PLANI I KATIT TË PARË , KUOTA +3.30




Në katin e parë në pjesën perëndimore të sheshit, ndodhen hapësirat e klasave të mësimit, laboratory fizik-kimi, si dhe hapësira e bibliotekes.

PLANI I SISTEMIMIT SH – 1:400





Është krijuar një rigjenerim i terrenit duke e ndarë atë në tre kuota të ndryshme me qëllim zvogëlimin e pjerrësisë. Kuota -90, kuota e hyrjës në parcelë. Kuota -45 është kuota e hyrjes për në objekt. Kuota ± 0.00 është kuota e pjesës së mbrapme të shkollës dedikuar totalisht fëmijëve të para-shkollorit dhe ambienteve sportive për nxënësit e 9-vjecares. Në sistemim, janë parashikuar hapësira gjelberimi dhe rekreative, terrene sportive, ambiente qëndrimi .. etj

PRERJE A-A SH – 1:200




PRERJE B-B SH – 1:250






FASADA LINDORE SH – 1:50




FASADA PERËNDIMORE SH – 1:50






FASADA VERIORE SH - 1:50



FASADA JUGORE SH - 1:50




ORTOFOTO TË ZONES:


Sip. e sheshit të ndërtimit – 2624 m²

Sip. e objektit ekzistues – 647 m²

Sip. e gjelberuar -1977 m²






PAMJE 3D




[Handwritten signature]









PUNOI: ARK. OKSANA BAXHO

DREJTORESHA E PLANIFIKIMIT: ING. MIMOZA HAXHIU